



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Ilir META



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2014**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar mbrojtjen e së drejtës së çdo personi për barazi para ligjit, parimin e barazisë dhe trajtimit për shanse dhe mundësi të barabarta, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminim, si përparësi kyçe drejt proceseve integruese të shtetit shqiptar;
- Duke inkurajuar dhe mbështetur veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur, i cili ka mision garantimin për mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore;
- Duke shprehur bindjen e tij se progresi i veprimtarisë së Komisionerit në drejtim të luftës kundër diskriminimit është i mundur vetëm në sajë të një sistemi harmonizimi dhe koordinimi real të të gjitha strukturave në nivel qendror e vendor, medias, shoqërisë civile dhe publikut;

Konstaton se gjatë vitit 2014:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka paraqitur një vështrim analizues të tipologjisë dhe fenomenologjisë së çështjeve aktuale të diskriminimit, bazuar në raportet zyrtare të institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse dhe gjetjeve të rezultuara gjatë veprimtarisë së tij.
2. Ka një përmirësim të ndjeshëm në performacën e këtij institucioni sa i takon informimit dhe ndërgjegjësimin e publikut, lidhur me kuptimin e diskriminimit, mekanizmat ligjorë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.
3. Ka një rritje jo të ndjeshme të numrit të ankesave të paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të ndryshme, krahasuar me pritshmëritë që ky institucion ka në përmbushje të misionit të tij ligjor dhe në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të rezolutës së korrikut 2014 të Kuvendit të

Shqipërisë, ku kërkohej rritja e numrit të ankesave. Duke iu referuar vetëm ankesave të paraqitura pranë KMD-së në vitin 2013, të cilat janë 166 dhe në vitin 2014, që janë 172, vërejmë se rritja konsiston vetëm në 6 ankesa më shumë të paraqitura përgjatë vitit 2014.

4. Ka një ulje të ndjeshme të numrit të ankesave të paraqitura nga organizatat jofitimprurëse, të cilat punojnë për mbrojtjen e të drejtave të grupeve vulnerabël, krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë që në raport vlerësohet forcimi i bashkëpunimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shoqërinë civile.

5. Ka një numër shumë të lartë të çështjeve të mbartura nga viti i kaluar, 128 çështje, dhe në raport nuk sqarohen arsytet e mbartjes.

6. Është ulur ndjeshëm numri i hetimeve të nisura kryesisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krahasuar me vitin e kaluar.

7. Ka një numër të ulët të aplikimit të masës administrative “gjobë”.

8. Ka një rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në proceset gjyqësore, duke e 3-fishuar pjesëmarrjen në gjykatë. Rritje të ndjeshme ka edhe në dhënien e mendimeve me shkrim për gjykatën dhe në kërkesat për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit nga gjykata për gjobat e vëna nga Komisioneri.

9. Pothuajse në të gjitha rastet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë zbatuar nga subjektet, të cilat kanë kryer diskriminim.

10. Raporti mes numrit të vendimeve për konstatim diskriminimi dhe numrit total të vendimeve të shqyrtuara është relativisht i ulët. Ky numër është relativisht i ulët edhe në raport me numrin total të ankesave të paraqitura me pretendim për diskriminim.

11. Ka një numër të ulët të ankesave, për shkak të aftësisë së kufizuar, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si dhe për shkak të gjinisë, të regjistruara pranë Komisionerit, në raport me situatat diskriminuese, me të cilat këto grupe vulnerabël përballen.

12. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ofruar mbështetje të nismave të ndryshme ligjore, duke propozuar 7 rekomandime legislative dhe ka dërguar rekomandime të ndryshme për çështje të diskriminimit, drejtuar institucioneve të administratës shtetërore, për përmirësimin e situatës për grupet vulnerabël.

13. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në zbatim të rezolutës së korrikut 2014 të Kuvendit të Shqipërisë, i ka intensifikuar konsultimet për përcaktimin e nevojave për ndryshimin e ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si pasojë e problematikave të reflektuara gjatë zbatimit të tij, por ende nuk ka dalë me rekomandime konkrete.

14. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka hartuar 2 studime, studimin “Mbi situatën e diskriminimit të komunitetit rom” dhe studimin “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri”, si dhe ka inicuar një monitorim të sektorit privat për aksesin e grupeve vulnerabël në punësim dhe një monitorim të vendimeve gjyqësore në fushën e mosdiskriminimit, të cilat janë në proces.

Kuvendi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015:

1. Të vazhdojë veprimtarinë institucionale në nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në vëmendje edhe të rekomandimeve të Progresraportit të KE-së për vitin 2014;

2. Të vazhdojë punën për konsolidimin e mëtejshëm të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në funksion të zbatimit të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në sistemin gjyqësor, si dhe në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të Progresraportit të KE-së për vitin 2014;

3. Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të grupeve vulnerabël, për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje, duke ndërmarrë fushata më të gjera, informuese dhe sensibilizuese për çështjet e diskriminimit, si në zonat urbane dhe në ato rurale, me qëllim rritjen e identifikimit të rasteve apo ankesave, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të Progresraportit të KE-së për vitin 2014;

4. Të punojë për rritjen e aksesit të publikut për adresimin e rasteve të mundshme të diskriminimit, duke thelluar lidhjet e drejtpërdrejta me opinionin publik, për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;

5. Të rrisë numrin e hetimeve administrative të nisura kryesisht;

6. Të përfshijë në raportin vjetor, për efekt transparence, shkaqet e mbartjes së ankesave nga viti i kaluar;

7. Të përfshijë në raportin vjetor, për efekt transparence, shkaqet e vendimeve për pushimin e çështjeve;

8. Të kryejë një monitorim më të thelluar të zbatimit të ligjit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të Progresraportit të KE-së;

9. Të monitorojë efektivitetin e ndryshimeve dhe përmirësimeve që ka pësuar kuadri ligjor përgjatë vitit 2014 në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe faktin nëse këto ndryshime kanë ndikuar apo jo në garantimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit;

10. Të rrisë shkallën e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Prokurorinë, institucionet publike qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, për zbatimin e masave në përputhje me detyrimet ligjore;

11. Të informojë Kuvendin e Shqipërisë, komisionet parlamentare dhe nënkomisionet përkatëse për problematikat dhe shqetësimet që dalin gjatë veprimtarisë institucionale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe për rekomandimet legislative që i drejton institucioneve shtetërore;

12. Të forcohet dhe të intensifikohet bashkëpunimi me OJF-të që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe veçanërisht që mbrojnë të drejtat e grupeve vulnerabël, me qëllim identifikimin dhe rritjen e numrit të shqyrtimit të rasteve të diskriminimit gjinor, diskriminimit për shkak të racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, të referuara prej tyre;

13. Të rrisë transparencën institucionale, përmes pasurimit të faqes zyrtare të institucionit, duke pasqyruar të gjitha aktivitetet dhe veprimtarinë e institucionit, vendimet e ankesave të shqyrtuara, informacione të plota dhe të përditësuara, si dhe të mundësojë portale, forume dhe anketime *online*, të aksesueshme për publikun, me qëllim sigurimin e një komunikimi të vlefshëm, në kohë dhe në interes të qytetarëve.

14. Të ketë një rol më aktiv në median kombëtare (vizive dhe të shkruar), me qëllim rritjen e vizibilitetit të këtij institucioni dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve, lidhur me misionin dhe kompetencat ligjore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i cili shqyrton çështjet e diskriminimit.

Miratuar në datën 21.5.2015